

W
R
UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare

Seanca nr.2004/11

Prishtinë, më 8 dhe 9 korrik 2004

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi Nexhat **DACI**, kryetar i Kuvendit, kurse bashkëkryesues ishte Bajram **Kosumi**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 88 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryesia ia kishte propozuar Kuvendit këtë

REND DITE:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme;
2. Shqyrtimi i propozimit për amendamentimin e Kornizës Kushtetuese;
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kinematografinë;
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tatimin në fitim;
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ujërat;
6. Shqyrtimi i pare i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Pyjet;
7. Shqyrtimi i pare i Projektligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja;
8. Shqyrtimi i pare i Projektligjit për të drejtat sendore;
9. Shqyrtimi i pare i Projektligjit për të drejtën familjare;
10. Shqyrtimi i pare i Projektligjit për konkurrencën;
11. Ratifikimi i Satutit të Universitetit të Prishtinës;
12. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e anëtarit të Bordit për Telekomunikacion;

13. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë për emërimin e kryetarit dhe të një anëtari të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, si dhe të kryetarit dhe të anëtarëve të Agjencisë për Prokurimin Publik dhe
14. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Gjyqësi, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese për emërimin e prokurorëve.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme

Proceverbali i seancës së mëparshme u miratua më vërejtjen e deputetës **Edi Shukriu** që të evidencohet në transkript diskutimi i saj lidhur me raportin përfundimtar të buxhetit të Kosovës.

2. Shyrtimi i propozimit për amendamentimin e Kornizës Kushtetuese

Kryetari i informoi deputetët për procedurën e formimit të Grupit të Punës për hartimin e propozimeve për ndryshimin dhe plotësimin e Kornizës Kushtetuese. Ai e ftoi kryetarin e Komisionit për Gjyqësi, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ta arsyetonte propozimin para deputetëve të Kuvendit.

Arsim Bajrami, në emër të Komisioni për Gjyqësi, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese dhe të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se me amendamentet e propozuara synohet që Qeveria e Kosovës dhe institucionet e tjera të Kosovës, në mandatin e ardhshëm, të pajisen me kompetenca të reja qeverisëse, që do shpiente kah përsheptimi i zgjidhjes të statusit përfundimtar të Kosovës.

Jemi të vetëdijshëm se këto amendamente janë larg dëshirës reale të qytetarëve të Kosovës, për ta pasur një Kushtetutë të mirëfilltë dhe të plotë.

Komisioni ka punuar një kohë të gjatë dhe ka kërkuar një bashkëpunim që nga fillimi me përfaqësuesit e Zyrës Ligjore të UNMIK-ut. Ata fillimisht kanë refuzuar të marrin pjesë, por më vonë, qëndrimi i tyre ka qenë se duhet të shtyhet votimi i amendamenteve për më vonë. Të formohet një Komision i përbashkët, i cili në një të ardhme do të përgatisë ndryshimet e Kornizës Kushtetuese.

Korniza Kushtetuese, pika 14.3 i jep të drejtë Kuvendit të Kosovës, që me mbështetjen e dy të tretave ta votojnë nismën për ndryshimin e Kornizës Kushtetuese, kurse autoriteti përfundimtar për ndryshimin e saj është PSSP-ja.

Ne mendojmë se ka mjaft hapësirë dhe kohë, që eventualisht çështjet kontestuese, të zgjidhen ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe UNMIK-ut, derisa PSSP-ja t'i nënshkruajë amendamentet për ndryshimin dhe plotësimin e Kornizës Kushtetuese.

Komisioni shumicën e amendamenteve të propozuara i ka hartuar me koncensus, kurse për ato amendamente që nuk ka arritur t'i hartojë me koncensus, i ka paraqitur në alternativë. Ne i propozojmë Kuvendit që t'i miratojë amendamentet e hartuara me